



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:104873

Datë: 14.06.2024

Numri i dokumentit: 05826202

KF.nr.248/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar administrativ të paditësit R.Z. B.I/ NTN “Rroni Riki” me seli në Prizren, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Ekrem Hoxha, avokat nga Prishtina, kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimi nr.89/2021 i datës 29.04.2021 i ATK-së, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të mbajtur në mungesë të përfaqësuesit të palës paditëse si dhe në mungesë të përfaqësuesit të palës së paditur, me datë 11.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit R.Z. B.I/ NTN “Rroni Riki”, me seli në Prizren, si e pa bazuar.
- II. MBETËT NË FUQI vendimi nr.89/2021, i datës 29.04.2021, i Administratës Tatimore të Kosovës me seli në Prishtinë.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi R.Z. B.I/ NTN “Rroni Riki”, me seli në Prizren, me padinë e paraqitur në Gjykatë me datë 28.05.2021, ka iniciuar kontest tregtar-administrativ kundër vendimit nr.89/2021 i datës 29.04.2021, të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës. Në padi paditësi ka theksuar se Raporti i kontrollit dhe vendimi nuk ka elaboruar situatën faktike financiare të paditësit në kapacitetin e tatimpaguesit mbi të cilin është nxjerr Raporti i Kontrollit dhe më tutje janë nxjerr aktet e ri-vlerësimeve, raporti i kontrollit, vendimi nr.89/2021 i datës 29.04.2021 dhe aktet e ri

vlerësimeve nuk kanë elaboruar shkaqet që kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të kryer dhe nuk ka paraqitur provat mbi të cilat ka mbështetur vlerësimet e saja lidhur me trajtimin e huazimeve si të hyra në transaksion, nuk ka potencuar bazën e saktë ligjore mbi të cilin ka nxjerr konstatime lidhur me huazimet para hyrjes në fuqi të UA nr.01/2016. Neni 19 paragrafi 2 i Ligjit nr.03/L-22 për Administratën Tatimore dhe Procedurat parasheh shprehimisht “Vlerësimi i Drejtorit të Përgjithshëm “ i cili do të bëhet sipas gjykimit të tij ose sa më të mirë dhe do të bazohet në të gjitha provat që ai ose ajo ka në dispozicion, përfshirë përcaktimet nga paragrafi 2.1 deri 2.6 të nenit 19 të LAPT, në bazë të gjendjes faktike dhe nga kuptimi i këtyre dispozitave ligjore të cituara, vlerësojmë se Kontrolli Tatimor nuk ka vepruar drejtë kur ka njohur huazimet si të hyra të krijuara nga aktiviteti i rregullt ekonomik përgjatë periudhës së kontrollit, nga shkresat e lëndës rezulton që paditësi në procedurën administrative të ankimit i ka prezantuar ATK-së dëshmitë të mjaftueshme për huazimet e krijuara, kontratat e nënshkruara, deklaratat, për të dëshmuar ndodhjen e këtyre huazimeve, mirëpo përkundër kësaj Kontrolli Tatimor, gjatë kontrollit në mënyrë evidente ka vepruar në kundërshtim me nenin 19.2 LAPT, për arsye se sipas kësaj dispozite ligjore kontrolli tatimor gjatë vlerësimit tatimor duhet të ishte bazuar në të gjitha provat që i ka në dispozicion duke përfshirë librat, regjistrimet, informatat e tatimpaguesit dhe çdo informate tjetër me të cilat verifikohet saktësia e deklaratave, librave dhe regjistrimeve të paditësit. Tutje ka theksuar se konkluzioni nga Raporti i Kontrollit ka konstatuar si shitje parcelën me nr.00159-3 ZK Dushanovë e cila është shitur me datë 26.09.20214 sipas kontratës nr.2033/2014 në vlerë prej 107,227.00 në periudhë 09-2014, pra vlerësimi nga e paditur nuk është i bazuar dhe i drejtë sepse nga ana e Gjykatës kompetente është bërë ndalesa për shitblerjen e kësaj parcele e cila dëshmohet me aktvendimin e gjykatës C.nr.854/14 datës 14.11.2014 për pasoj blerësi nuk ka pasur mundësi që të bëjë transferin e pronës nga shitësi tek blerësi. Më tej ka shtuar se të gjitha huadhëniet në formë të keshit për të cilat tatimpaguesi ka sjell dëshmitë të njëjtat nuk janë konsideruar si dëshmi të cilat i plotësojnë kërkesat e nenit 19 UA 1/2016 dhe si të tilla i njëjti inspektor i ka konsideruar si të hyra për paditësin, në mungesë të informatave për veprimtarit tjera të tatimpaguesit atëherë i njëjti këto shuma i ka trajtuar dhe konsideruar si të ardhura që lidhen me transaksione për shitblerjen e tokave dhe janë tatimuar vetëm për Tatimin mbi të Ardhura Personale (TAP) dhe jo për TVSH. Gjykatës i ka propozuar që të pranohet në tërësi padia dhe kërkesëpadia, të anulohet në tërësi vendimi i kundërshtuar, të lirohet paditësi nga detyrimi i pagesës së tatimit shtesë në të ardhura personale në vlerë prej 171,580.70 € dhe të detyrohet e paditura që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës gjyqësore. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor të datës 11.06.2024 nuk ka prezantuar askush për paditësin edhe pse për këtë seancë, përfaqësuesi i palës paditëse avokati Ekrem Hoxha ka qenë i njoftuar për

datën dhe orën e kësaj seance, që vërtetohet me nënshkrimin e procesverbalit të datës 02.05.2024, ndërsa mungesën-mospjesëmarrjen nuk e ka arsyetuar.

E paditura, në përgjigjen në padi të datës 09.12.2024, i kundërshton në tërësi pretendimet e paraqitur në padi, si të pa bazuar në ligj dhe faktet materiale. Ka shtuar se sa i përket pretendimit të palës paditëse se vendim i të paditurës është nxjerr me shkelje dhe në kundërshtim me nenin 19, paragrafi 2 të Ligjit 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, një konstatim i tillë është i pa vërtetë sepse pikërisht vendimi i ATK-së është nxjerr bazuar në legjislacionin tatimor, përkatësisht në zbatim të kësaj dispozite ligjore kur është kundërshtuar nga pala e paditur, dhe paditësi përveç që konstaton se vendimi është në kundërshtim me ligjin asgjë konkrete nuk konstaton, kontrollon ka konstatuar drejtë gjendjen faktike, në zbatim të nenit 19, paragrafi 2 i Ligjit nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, nga dokumentet e prezantuara nga vet paditësi dhe informata nga palët e treta, pra pretendimet e palës paditëse në padi nuk janë të vërteta. Tutje ka theksuar se sa i përket qarkullimit shtesë lidhur me kontratën nr.2033/2014, për periudhën 09/2014, se për pronën në fjalë është bërë ndalesë nga gjykata për shitblerjen e kësaj parcele vërtetohet si e pa bazuar për faktin se ATK-ja pas analizimit profesional të aktgjykimit, gjykata me këtë aktgjykim ka vendosur masën e sigurimit, por në asnjë rast nuk e ka anuluar kontratën për Shitjen e Paluajtshmërisë nr.2033/2014 të datës 26.09.2014, sipas të cilit kontrolli këtë kontratë e ka trajtuar si shitje për qëllime tatimore. Tutje ka shtuar se sa i përket pretendimit të paditësit lidhur me huadhëniet të trajtuara si shitje shtesë nga kontrollon, një pretendim i tillë nuk qëndron për faktin se ATK-ja pas analizimit të provave materiale në shkresat e lëndës, kontrollon konstaton se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me vlerësim sipas dispozitave ligjore të Udhëzimit administrativ nr.01/2016, neni 19 i po këtij Udhëzimi, sepse në rastin konkret paditësi nuk ka arritur të dëshmojë me prova materiale se mjetet e transferuara (deponuara) në llogarinë bankare, me përshkrim kthim i huave nga personat e ndryshme me të vërtet janë dhënë hua përkatësisht në shkresat e lëndës nuk mund të provohet se mjetet e pretenduara si të dhëna huadhënie (të depozituara në llogarinë bankare) e kanë burimin nga të ardhura të pa tatueshme.

Gjykata ka shqyrtuar këtë kontest tregtar - administrativ konform dispozitave të nenit 41 të LKA-së, në mungesë të palës së paditur ngase me parashtesën e datës 30.05.2024 e ka njoftuar gjykatën se nuk do të prezantoj në seancën e datës 11.06.2024 duke kërkuar nga gjykata që të veproj në pajtim me nenin 38 paragrafi 5 të LKA-së. Gjithashtu ka kërkuar që të refuzohet padia/ankesa e paditësit në tërësi si e pa bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi nr.89/2021 i datës 29.04.2021.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 11.06.2024, ka administruar provat si në vijim: Raporti i kontrollit, Ankesë e paditësit në ATK e datës 02.03.2021, Vendimi kontestues nr. 89/2021 i datës 29.04.2021, Deklaratë e datës 10.09.2008, Xhirollogaria në Pro Credit Bank për periudhën 01.01.2010 deri 25.08.2011, Përgjigja në padi e datës 09.12.2021, Aktvendim C.nr 2050/19, Aktvendim C.nr858/14, Gjendja e përgjithshme e deklarimeve dhe transaksioneve të tjera, Gjendja e borxheve, Informatat nga palët e treta Pro Credit Bank, Teb Bank.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar - administrativ, bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë kontest tregtar - administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, Gjykata konstaton se e paditura Divizioni i Ankesave i ATK-së, e ka refuzuar ankesën e subjektit në procedurë, duke konstatuar se vlerësimi i kontrollit për tatim shtesë është bërë duke u bazuar në dokumentacionin e prezantuar nga tatimpaguesi dhe nga informatat nga palët e treta (ekstrakte bankare) bazuar në nenin 19 paragrafi 1 i Ligjit nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, neni 29 të Udhëzimit Administrativ nr.15/2010 për Zbatimin e Ligjit nr.03/L-222. Ka cekur se Divizioni i Ankesave pas analizimit të provave në lëndë vërteton se tatimpaguesi nuk ka krijuar dhe mbajtur regjistrimet e parapara në nenin 13 të Ligjit nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, nenit 17 të UA nr.15/2010, rrjedhimisht i njëjti nuk i ka vlerësuar obligimet tatimore sipas nenit 18 të Ligji nr.03/L-222, respektivisht të hyrat e krijuara nga kontrata kontestuese nuk janë deklaruar për qëllime tatimore. Sa i përket pretendimit në lidhje me transaksionet e pretenduara si huadhënie, të trajtuara si shtije shtesë, pas analizimit të provave ka vendos se në rastin konkret nuk ka të bëjë me vlerësim sipas dispozitave ligjore të UA nr.01/2016, nenit 19, sepse tatimpaguesi nuk ka arritur të dëshmojë me prova materiale se mjetet e transferuara në llogarinë bankare janë dhënë hua. Nga arsyet e cekur është vendosur që ankesa e tatimpaguesit të refuzohet bazuar në nenin 132 paragrafi 2 i Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën Administrative.

Gjykata pretendimin e paditësit në lidhje me vlerësimin e qarkullimit shtesë lidhur me kontratën nr.2033/2014 për periudhën 09/2014 nën arsyetimin se për pronën në fjalë është bërë ndalesa nga gjykata për shitblerjen e kësaj parcele e vlerëson si të pa bazuar për arsye se Gjykata me Aktgjykim ka vendosur masën e sigurimit, por në asnjë rast sipas dispozitave të aktgjykimit nuk është anuluar Kontrata për Shitjen e Paluajtshmërisë nr.2033/2014 datë 26.09.2014, andaj e paditura me të drejtë këtë kontratë e ka trajtuar si shitje për qëllime tatimore, pra paditësi nuk ka krijuar dhe nuk mbajtur regjistrime e parapara në nenin 13 të Ligjit nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, neni 17 të UA nr.15/2010, i njëjti nuk i ka vlerësuar obligimet tatimore sipas nenit 18 të Ligjit nr.03/L-222, ku të hyrat e krijuara nga kontrata kontestuese nuk janë deklaruar për qëllime tatimor.

Sa i përket pretendimit të paditësit lidhur me transaksionet të cilat i ka quajtur si huadhënie gjykata e vlerëson edhe këtë pretendim si të pabazuar për arsye se paditësi nuk ka arritur të dëshmoj me prova materiale se mjetet e deponuara në llogarinë bankare me përshkrimin kthimi i huave, me të vërtet janë dhënë hua, pra nga shkresat e lëndës nuk mund të provohet se mjetet e pretenduara si dhënia e huas e kanë burimi nga të ardhurat e pa tatueshme, andaj me të drejtë e paditura i ka vlerësuar si të hyra shtesë sipas metodës indirekte të paraparë me nenin 19 paragrafi 3 i Ligjit nr.03/L-222, përkatësisht nenit 30 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 i UA nr.15/2010.

Nga kjo gjendje faktike, Gjykata ka pranuar si të bazuar arsyetimin e vendimit të paditurës, për arsye se paditësi nuk ka arritur të argumentojë me prova konkrete një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga e paditura me vendimin kontestues dhe se dëshmitë e parashtuara nga paditësi nuk kanë ndikim në vendosje ndryshe në këtë çështje administrative. Gjykata ka shqyrtuar ligjshmërinë e aktit administrativ brenda kufijve të kërkesëpadsisë, në vështrim të nenit 44 të LKA-së. Gjykata nuk ka mundur t'i merr për bazë pretendimet e paditësit të theksuara në padi sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e organit të paditur, në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës dhe me dispozitat ligjore në fuqi.

Gjykata, konform nenit 43, paragrafi 1, të LKA-se vendos për çështjen e konfliktit administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative. Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ gjykata nuk ka mundur të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga gjendja të cilën e ka konstatuar organi i paditur gjatë procedimit

administrativ, për arsye se as në këtë konflikt administrativ paditësi nuk ka qenë në gjendje që gjykatës t'ia dëshmoj provat. Andaj, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke refuzuar kërkesëpadinë si të pabazuar dhe duke lënë në fuqi vendimin e të paditurës nr.89/2021, i datës 29.04.2021.

Gjykata për shpenzimet e procedurës vendosi konform nenit 64 të LKA-së.

Nga të cekurat më lart, Gjykata konform nenit 43, par 1, dhe 46, par 1 dhe 2, të LKA-së, Ligji nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE

Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.248/22 datë 11.06.2024

Gjyqtarja
Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh ngadita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.